ALB BB
*Auditing*

# Raporti i Audituesit te Pavarur

Ne Vemendje te Mbledhjes se pergjithshme te aksionerit:
Banka e Kreditit te Shqiperise sh.a.
Rruga "Perlat Rexhepi",
Al-Kharafi Group Adm. Build. Kati 1&2,
Tirane, Albania.

Tirane me 12 Mars 2014

*Raportim ne lidhje me Pasqyrat Financiare*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkelidhur te Banka e Kreditit te Shqiperise sh.a. (Banka), te cilat perfshijne Pozicionin Financiar per vitin qe mbyllet me date 31 Dhjetor 2013 dhe pasqyrat perkatese te Ardhurave Gjitheperfshirese, Ndryshimit te Kapitaleve te veta dhe te Flukseve te mjeteve monetare per kete vit ushtrimor si dhe nje permbledhje te politikave me kryesore te kontabilitetit dhe shenimet shpjeguese.

*Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare*

Drejtimi mban pergjegjesi per pregatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar. Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem per pregatitjen e pasqyrave financiare qe me mos permbajne anomali dhe gabime materiale, duke zgjedhur dhe aplikuar politika te pershtatshme te kontabilitetit; dhe duke bere vleresime te arsyeshme kontabel ne varesi te situates.

*Pergjegjesia e Audituesit*

Pergjegjesia e jone eshte, qe bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Auditimin e kemi kryer ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te jemi ne perputhje me kerkesat e etikes dhe qe te planifikohet dhe te kryhet auditimi per te marre sigurine e aresyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali dhe gabime materiale.

Nje auditim perfshin kryerjen e procedurave per marre evidencat e auditimit rreth shifrave dhe paraqitjeve ne pasqyrat financiare. Keto procedura te cilat zgjidhen ne varesi te gjykimit te audituesit, perfshijne vleresimin e rrezikut te gabimeve materiale te pasqyrave fianciare, qe mund te kene ndodhur per shkak te mashtrimit ose te gabimeve. Per realizimin e vleresimit te ketyre rreziqeve, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare te shoqerise me qellim te hartoje procedura te auditimit te pershtatshme sipas situates, por jo me qellimin e shprehjes se nje opinioni ne lidhje me efektivitetitn e kontrollit te brendshem te shoqerise. Nje auditimin perfshin vleresimin e pershtatshmerise te politikave kontabel te perdoruara dhe arsyeshmerine e vleresimeve kontabel te bera nga drejtimi si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme qe evidenca e auditimit qe kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per tu perdorur si baze ne dhenien e opinionit tone te audituesit.

ALB BB
*Auditing*

*Çeshtje ne Vemendjen Tuaj*

Pa dashur te kualifikojme opinion tone ne terheqim vemendjen ne pikat ne vijim;

1. **Shenimi nr 5: Gjykime te Drejtimit – pika a) Biznesi ne vijemesi.**

Drejtimi gjate periudhes ushtrimore 2016 vijoi te diskutoje ceshtjet qe lidhen me vijimesine e biznesit. Ky diskutim eshte kryer duke pasur parasysh gjetjet e Departamentit te Mbikyrjes se Bankes se Shqiperise gjate inspektimit ne vend te periudhes ushtrimore 2008. Ne kete raport nenvizohet qe aktiviteti i bankes nuk ka nje impakt ne zhvillimin e komunitetit dhe te sistemit financiar dhe si rrjedhoje aksionari duket te gjeje mundesite per te rritur burimet dhe permiresojme impaktin ne kete sistem, qodte dhe kundrejt shitjes se paketes se aksioneve. Drejtimi informoi Aksionerin ne lidhje me sa me siper. Drejtimi i bankes se bashku me Aksionerin jane duke kerkuar bleres te tjere. Megjithate, ne daten e pergatitjes se raportimit financiar per periudhen qe u mbyll me 31 dhjetor 2013, nuk ka masa te tjera per te realizuar rekomandimet e Bankes se Shqiperise. Drejtimi i Bankes mendon se Aksioneri do te realizoje keto rekomandime shpejt dhe si rrjedhoje ka supozuar qe Raportimi Financiar per periudhen qe u mbyll me 31 dhjetor 2013, do te ndertohet bazuar ne faktin qe banka do te vijoje me aktivitetin bankar.

2. **Shenimi nr 5: Gjykime te Drejtimit – pika b) Humbjet nga Rivleresimi i Aktiveve dhe Detyrimeve Monetare**

Veprimet ne Valute te Huaj te Bankes jane shoqeruar me nje rivleresim te pozicionit te huaj valutor ne USD ne Lek 56 mln ( 2012: 23mln), i cili rrjedh kryesisht nga rivleresimi i zerave monetare sipas pershkrimit te dhene ne politiken kontabel 3.a.

Ne rast se efekti i mesiperm do te ishte zero, atehere fitimet nga aktiviteti bankar te llogaritura para shpenzimeve te pergjithshme dhe administrative do te ishin Lek 24 mln ( 2012: 24mln) duke treguar nje rezultat te pandryshuar gjate periudhave nga veprimtaria bankare, qe konvergon me diskutimin e Biznesit ne vijimesi sa me lart.

3. **Shenimin 25 te Raportimit Financiar, Palet e Lidhura**

Banka ka kryer transaksione te rendesishme me palet e lidhura. Keto transaksione perfaqesojne nje pjese te rendesishme ( 100%) te portofolit te Kredise dhe Paradhenieve ndaj Klienteve Lek 247 mln ( 2012: 56mln) si dhe te Depozitave te Klienteve Lek 174 mln ( 2012: 177 mln) , ku vlen te theksohet qe aktiviteti i kredidhenies eshte kryer ne perputhje me legjislacionin bankar. Keto transaksione kane influencuar ne nje mase te rendesishme rezultatin e te ardhurave dhe shpenzimeve dhe si rrjedhoje Rezultatin Para Tatim Fitimit.

*Opinion*

Sipas opinionit tone, duke pasur parasysh dhe ceshtjet per sa me siper permendur, pasqyrat financiare, te marra ne teresi dhe ne te gjithe aspektet materiale, japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte te situates financiare te Bankes me 31 Dhjetor 2013, te rezultateve te veprimatarive te saj, te fluksit te mjeteve monetare per periudhen kontabel te mbyllur ne kete date, ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar.

Firma : Lavdimir Fusha
Drejtues i Auditimit
ALB BB Auditing Sh.p.k.

Date : 12 Mars 2014

ALB BB Auditing Shpk- a Correspondent Firm of Russell Bedford International
Rr. Bulv "Gjergj Fishta", Nd. 16, H.9, Ap. 20, Njesia Bashkiake Nr. 10, Kodi Postar 1001, Tiranë –Albania,
E-mail: info@albanianaudit.com; Tel: ++3554 2 427 019, Mob. +355 692067870

Banka e Kreditit te Shqiperise Sh.a.

Pasqyrat Financiare per periudhen ushtrimore qe u mbyll me 31 dhjetor 2013

(se bashku me raportin e audituesit te pavarur)

PERMBLEDHJE

1. E PERGJITHSHME ... 7
2. PERMBLEDHJA E POLITIKAVE TE KONTABILITETIT ... 7
3. POLITIKAT KRYESORE KONTABILITETIT ... 8
A. TRANSAKSIONET NE MONEDHE TE HUAJ ... 8
B. TE ARDHURAT NGA INTERESAT ... 8
C. TATIMI FITIMI ... 9
D. AKTIVET FINANCIARE DHE DETYRIMET ... 9
E. PARAJA DHE EKUIVALENTET E PARASE ... 11
F. HUATE DHE PARADHENIET ... 11
G. INVESTIMET ... 11
H. TE MBAJTURA DERI NE MATURIM ... 11
J. QIRAJA ... 11
K. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE ... 11
L. AKTIVET JO-MATERIALE AFATGJATA ... 12
M. TESTI I VLERES I AKTIVEVE JO-FINANCIARE ... 12
N. DEPOZITAT, HUAMARRJA DHE BORXHI I VARUR ... 13
O. PROVIGJIONET ... 13
P. GARANCITE FINANCIARE ... 13
Q. PERFITIMET E PUNEMARRESVE ... 13
R. KAPITALI DHE REZERVAT ... 13
S. RAPORTIMI SEGMENTAR ... 14
T. STANDARTE DHE INTERPRETIME TE REJA TE PA PERSHTATURA AKOMA ... 14
4. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR ... 14
4.1 HYRJE MBI RISKUN ... 14
4.2 RISKU I KREDISE ... 14
4.3 RISKU I LIKUIDITETIT ... 19
4.4 RISKU I TREGUT ... 21
4.5 RISKU I NORMAVE TE INTERESIT ... 23
4.6 RISKU OPERACIONAL ... 24
4.7 MENAXHIMI I KAPITALIT ... 24
5. GJYKIME DHE VLERESIME TE RENDESISHME TE DREJTIMIT ... 26
6. RAPORTIMI SEGMENTAR ... 28
7. VLERA E DREJTE E INSTRUMENTAVE FINANCIARE ... 30
8. TE ARDHURAT NETO NGA INTERESAT ... 31
9. TE ARDHURAT NGA KOMISIONET, NETO ... 32
10. SHPENZIMET OPERATIVE ... 32
11. SHPENZIMET E TATIMIT KORRENT ... 33
12. MJETET MONETARE DHE GJENDJET ME BANKAT ... 34
13. INVESTIMET E MBAJTURA DERI NE MATURIM- BONO THESARI ... 35
14. HUATE DHE PARADHENIET NDAJ KLIENTELES ... 35
15. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE ... 36
16. NDERTESA, MJETE DHE PAJISJE KRYESORE ... 36
17. AKTIVE TE TJERA ... 38
18. HUA NGA BANKAT ... 38
19. LLOGARITE E KLIENTEVE ... 39
20. DETYRIME TE TJERA ... 40
21. TATIM FITIMI I SHTYRE ... 40
22. KAPITALI ... 40
23. MJETET MONETARE DHE TE NGJASHME ... 40
24. ANGAZHIMET JASHTE BILANCIT ... 41
25. VEPRIMET ME PALET E LIDHURA ... 41
26. NGJARJET JASHTE BILANCIT ... 42

## Pasqyra e te Ardhurave Gjitheperfshirese per Periudhen nga 1 janar deri me 31 dhjetor 2013

| | Notes | 2013 | 2012 |
|---|---|---|---|
| Interesa | | | |
| Te Ardhura nga Interesat | | 24,058 | 25,840 |
| Shpenzime per Interesat | | (12,544) | (11,201) |
| **Te Ardhura/Humbje Neto nga interesat** | 8 | 11,514 | 14,640 |
| Te Ardhura nga Komisionet | | 1,728 | 1,878 |
| Shpenzime per Komisionet | | (506) | (464) |
| **Te Ardhura/Humbje Neto nga Komisionet** | 9 | 1,222 | 1,414 |
| Fitime ( Humbje ) Nga Kembimet valutore | 4.4,5, 22 | (47,377) | (19,035) |
| Te Ardhura Tjera | | 3,038 | 3,105 |
| Humbje (Fitime) Nga rivleresimi i Kredive dhe paradhenieve | 14 | 300 | 123 |
| Shpenzimet e pergjithshme administrative | 10 | (66,738) | (92,158) |
| Te tjera shpenzime operative | | (15,809) | (16,475) |
| **Te Ardhura nga Veprimtari Operacionale** | | (126,786) | (124,439) |
| **Fitim/Humbje perpara Tatimit** | | (114,049) | (108,385) |
| Tatimi mbi te Ardhurat | 11,22 | - | (1,415) |
| Fitim/Humbja Neto e Vitit | | (114,049) | (109,800) |
| **Rezultati I periudhes** | | (114,049) | (109,800) |
| Rivleresime te pa realizuara pas taksave | | | |
| Fitim/humbje te Pashperndara | | | |
| Diferenca nga kursi I kembimit | | | |
| **Te ardhura Tjera neto** | | 0 | 0 |
| **Totali te ardhurave neto** | | (114,049) | (109,800) |

*Pasqyrat financiare lexohet se bashku me shenimet shpjeguese 1-27.*

(Vlerat ne '000 Lek, perveç se kur shenohet)

## Pasqyra e Pozicionit Financiar per periudhen qe u mbyll me 31 dhjetor 2013

| | Notes | 2013 | 2012 |
|---|---|---|---|
| Arka dhe Banka Qendrore | 12 | 1,204,454 | 1,157,962 |
| Hua dhe paradhenie te dhena Bankave dhe Institucioneve Financiare | | | |
| Letra me Vlere te Investimit | 13 | 103,859 | 105,917 |
| Rezerva e Detyruar | | 21,608 | 15,034 |
| Hua dhe Paradhenie neto per Klientet | 14.1 | 247,061 | 256,950 |
| Aktivet AfatGjata te patrupezuara | 15 | 4,533 | 6,043 |
| Aktivet AfatGjata te Trupezuara | 16 | 180,727 | 194,908 |
| Aktive te Tjera | 17 | 525 | 787 |
| **Totali i Aktivit** | | **1,762,766** | **1,737,602** |
| Reverse repo | 18 | 69,025 | 51,533 |
| Detyrime ndaj Bankave | 18 | 132,605 | 134,116 |
| Llogarite e Klienteve | 19 | 513,042 | 392,211 |
| Detyrime te Tjera | 20,21 | 33,993 | 31,593 |
| **Totali i detyrimeve** | | **748,666** | **609,453** |
| Kapitali i Aksionereve | 22 | 1,318,227 | 1,318,227 |
| Ndryshim ne Politikat Kontabel | 22 | (249,215) | (249,215) |
| Fitim/Humbja e Pashperndare | 22 | (54,912) | 59,137 |
| **Totali i Kapitalit te Aksionereve** | | **1,014,100** | **1,129,564** |
| **Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit te Aksionereve** | | **1,762,766** | **1,737,602** |

*Pasqyrat financiare lexohet se bashku me shenimet shpjeguese 1-27.*

Shumat ne '000 Lek, [illegible]

## Pasqyra e ndryshimit te Flukseve te Mjeteve Monetare per Periudhen 1 janar deri me 31 dhjetor 2013

| | Notes | 2013 | 2012 |
|---|---|---|---|
| **Fitim/Humbja Neto i Vitit** | | (114,049) | (109,800) |
| **Rregullimet per rikoncilimin e Fitim/Humbjes Neto me Cash-in Neto te Perfituar nga Aktivitetet Operative** | | | |
| Diference Rivleresimi per Kapitalin | 14,1 | | |
| Diference Rivleresimi Nga Hua dhe Paradhenie | 14,2 | | |
| Zhvleresim i Nderteses, Makineri dhe Paisje | 16 | 14,298 | 14,803 |
| Zhvleresimi i Shpenzimeve per t'u Amortizuar ne disa Vite | 15 | 1,511 | 1,072 |
| Amortizimi | 14,1 | (100) | (123) |
| Shpenzime per Interesat | 8 | (24,058) | (25,840) |
| Te Ardhura nga Interesat | 8 | 12,544 | 11,201 |
| *Ndryshime ne Kapitalin Punues dhe Detyrime:* | | | |
| Rritje/Zvogelim ne Rezerven e Detyrueshme | 12,1 | (6,575) | (4,560) |
| Rritje/Zvogelim ne Hua dhe paradhenie te dhena Bankave dhe Institucioneve Financiare | | | |
| Rritje/Zvogelim ne Hua dhe Paradhenie neto per Klientet | 14,1 | 9,989 | 12,419 |
| Rritje/Zvogelim Qera Financiare | 14,2 | 0 | 0 |
| Rritje ne Shpenzime per t'u Amortizuar ne disa Vite | 14,2 | 0 | 0 |
| Rritje/Zvogelim Aktive te Tjera | 16 | 1,677 | 7,851 |
| Rritje/Zvogelim ne Detyrimet ndaj Bankave | 17 | 15,981 | 84,343 |
| Rritje/Zvogelim ne Detyrimet ndaj Klienteve | 18 | 120,832 | 29,073 |
| Rritje/Zvogelim ne Tatim I pagueshem | 20 | (3,415) | |
| Rritje/Zvogelim ne detyrime te tjera | 20,21 | 2,400 | (18,385) |
| Interesi i Arketuar | | 24,058 | 25,840 |
| Interesi i Paguar | | (12,544) | (11,201) |
| Fluksei Monetare Neto nga Veprimtaria Operative | | **44,550** | **17,293** |
| *Flukset Monetare nga Aktivitetet e Investimit* | | | |
| Blerje ne investimet qe mbahen deri ne maturitet | | | |
| Blerjet neto te aktiveve te paprekshme | 16 | 2,059 | (9,713) |
| Blerjet neto te aktiveve fikse | 15 | 0 | (3,449) |
| Arketime nga Shitja e Mjeteve Fikse | 16 | (117) | (297) |
| **Flukset Monetare Neto nga Aktivitetet e Investimit** | | **1,942** | **(13,457)** |
| *Flukset Monetare nga Aktiviet e Financimit* | | | |
| Rritje ne Kapitalin e Nenshkruar dhe te Paguar | 22 | 0 | 0 |
| Kapitali i Nenshkruar dhe i Papaguar | 22 | 0 | 0 |
| Reserva Ligjore | 22 | 0 | 0 |
| **Flukset Monetare Neto nga Aktiviet e Financimit** | | **0** | **0** |
| **Rritja/Renia ne Mjetet Monetare dhe Ekuivalente me To** | | **46,492** | **3,836** |
| **Mjetet Monetare dhe Ekuivalentet me To ne Fillim te Vitit** | | **1,157,962** | **1,154,126** |
| **Mjetet Monetare dhe Ekuivalentet me To ne Fund te Vitit** | 23 | **1,204,454** | **1,157,962** |

*Pasqyrat financiare lexohet se bashku me shenimet shpjeguese 1-27*

Pasqyra e ndryshimit te kapitalit aksioner per periudhen 1 janar deri me 31 dhjetor 2013

| | Paid-up Capital | Translation exposure | changes in Account Pol | Retained Earnings / (Accumulated losses) | Total |
|---|---|---|---|---|---|
| **Gjendja ne 01 Janar 2011** | 1,318,227 | 0 | (249,215) | 168,936 | 1,237,948 |
| **Rezultati i periudhes** | | | | (109,800) | (109,800) |
| Rivleresime te pa realizuara pas taksave | | | | | |
| Fitim/humbje te Pashperndara | | | | | |
| Diferenca nga kursi I kembimit | | | | | |
| Total amount recognized directly in equity | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Totali te ardhurave neto** | | | | (109,800) | (109,800) |
| Rritja e Kapitalit | | | | | 0 |
| Ndryshime ne Diferencat e Rivleresimit | | | | | 0 |
| Shperndarja e Fitimeve | | | | | 0 |
| Fitim/humbje te Pashperndara | | | | | 0 |
| **Gjendja me 31 Dhjetor 2012** | 1,318,227 | 0 | (249,215) | 59,137 | 1,128,149 |
| **Rezultati i periudhes** | | | | (114,049) | (114,049) |
| Rivleresime te pa realizuara pas taksave | | | | | 0 |
| Fitim/humbje te Pashperndara | | | | | 0 |
| Diferenca nga kursi I kembimit | | | | | |
| Total amount recognized directly in equity | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Totali te ardhurave neto** | | | | (114,049) | (114,049) |
| Rritja e Kapitalit | | | | | 0 |
| Ndryshime ne Diferencat e Rivleresimit | | | | | |
| Shperndarja e Fitimeve | | | | | |
| Fitim/humbje te Pashperndara | | | | | 0 |
| **Gjendja me 31 Dhjetor 2013** | 1,318,227 | 0 | (249,215) | (54,912) | 1,014,100 |

*Pasqyrat financiare lexohet se bashku me shenimet shpjeguese 1-27.*

Raportimi Financiar i Bankes se Kreditit te Shqiperise sha per periudhen ushtrimore qe u mbyll me 31 dhjetor 2013 u aprovuan ne mbledhjen e ____________ dhe u firmosen nga:

President
Omar Dessouki

Drejtues Ekzekutiv
Sherine Kamel

## 1. E PERGJITHSHME

Banka e Kreditit te Shqiperise sh.a.( e quajtura Banka) eshte nje shoqeri aksioner shqiptare me qender ne Tirane, e cila operon ne tregun bankar,duke siguruar nje game te gjere produktesh ne sherbime, vecanarisht tranferta nepermjet suportit ten je rrjeti te gjere korrespondentesh nderkombetare.

Me 31 Dhjetor 2013 banka operonte nga qendra ne Tirane dhe 2 dege . Ne 31 dhjetor 2013 banka kishte 29 punonjes (2012: 29 staf), duke perfshire nje menaxher te huaj qe operon kryesisht ne territorin e Shqiperise.

Banka, e cila eshte e regjistruar ne regjistrin tregtar te gjykates se Tiranes vendim nr.27845, date 03/06/2002 bazuar ne ligjin nr.7638 date 19/11/1992 "Mbi kompanite tregetare" dhe eshte subject I ligjit nr 8269 mbi "Banken e Shqiperise" date 23/12/1997 dhe ligjit nr.9662 "Mbi Bankat e Republiks se Shqiperise" date 18/12/2006.

Ne 31 dhjetor 2013 numri I aksioneve ne total eshte 14,100 te mbajtura nga keta aksionere:

| | |
|---|---|
| Jasim Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi | 4,700 aksione |
| Fauzi Mohamed Abdulmohsen Al-Kharafi | 4,700 aksione |
| Marzouq N N A Al-Kharafi | 1,030 aksione |
| Bader N N A Al-Kharafi | 1,030 aksione |
| Hetaf N N A Al-Kharafi | 509 aksione |
| Faisal N N A Al-Kharafi | 1,030 aksione |
| Hebah N N A Al-Kharafi | 509 aksione |
| Fawziya Sulaiman A.S.A Al-Rifai | 592 aksione |

## 2. PERMBLEDHJA E POLITIKAVE TE KONTABILITETIT

### (a) *Baza e pergatitjes*

Pasqyrat financiare te Bankes se Kreditit te Shqiperise Sha dhe shenimet shpejguese per periudhen udhtrimore qe u mbyll me 31 dhjetor 2013 jane pregatitur ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (IFRS-te), ashtu siç jane publikuar nga Bordi Nderkombetar i Standarteve te Kontabilitetit ("IASB"), interpretimet e nxjerra nga Komiteti Nderkombetar i Raportimit te Interpretimeve Financiare ("IFRIC") ose ish Komiteti i Interpretimit - Standing Interpretations Committee ("SIC"), ne vijim te kerkesave te nenit 47 i Ligjit nr 9662 date 18 Dhjetor 2006 "Per Bankat ne Republiken e Shqiperise" dhe Ligji nr. 9228 "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

### (b) *Bazat e matjes*

Pasqyrat financiare jane paraqitur ne Lek Shqiptar dhe jane pregatitur mbi bazen e kostos historike pervec disa instrumenteve financiare.

- Instrumentet financiare derivative jane matur me vlere tregu
- Instrumentet financiare me vlere tregu nepermjet fitimit ose humbjes jane matur me vlere tregu
- Aktivet financiare te gatshme per t'u shitur jane matur me vlere tregu
- Investimet ne Aktive afatgjata materiale maten me vlere tregu
- Detyrimet per tu paguar jane matur me vlere tregu

### *(c) Monedha funksionale dhe e prezantimit*

Keto pasqyra financiare jane paraqitur ne Leke Shqipetar (ALL), e cila eshte monedha funksionale e Bankes. Informacionet financiare, me përjashtim se kur tregohet, jane paraqitur te rrumbullakosura ne 000 leke.

### *(d) Perdorimi i gjykimeve ne lidhje pasqyrat financiare*

Pergatitja e pasqyrave financiare kërkon si berjen e gjykimeve, vleresimeve dhe supozimeve qe ndikojne ne zbatimin e politikave te kontabilitetit si dhe ne shumen e raportuar te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime.

Vleresimet dhe supozimet e nenkuptuara perseriten ne menyre te vazhdueshme. Rishikimi I politikave te kontabilitetit njihet ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar dhe ne cdo periudhe te ardhshme te ndikuar. Informacione rreth zonave te rendesishme te pasigurise se vleresimit dhe gjykimeve kritike ne zbatimin e politikave te kontabilitetit te cilat kane ndikimin me te madh ne te dhenat e paraqitura ne pasqyrat financiare.

## 3. POLITIKAT KRYESORE KONTABILITETIT

### *a. Transaksionet ne monedhe te huaj*

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale (Lek Shqipetar) duke perdorur kursin e kembimit ne datat e transaksioneve. Fitimet dhe humbjet qe rezultojne nga kryerja e transaksioneve te tilla dhe nga kembimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare te shprehura ne monedhe te huaj me kursin e kembimit te fund-vitit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare qe maten me monedhe te huaj si pasoje e kostos historike, kthehen duke perdorur kursin e kembimit ne datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare te shprehura ne monedhe te huaj qe deklarohen me vlere tregu kthehen ne Lek Shqiptare me kursin e kembimit ne datën ne te cilen u percaktua vlere tregu. Kursi i kembimit i aplikuar (Lek ne njesine e monedhes se huaj) per monedhat kryesore per 31 Dhjetor 2013 paraqiten me poshte:

| | CAD | CHF | DKK | EUR | GBP | USD |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 31 dhjetor 2013 | 95.7 | 114.41 | 18.81 | 140.2 | 168.39 | 101.86 |
| 31 dhjetor 2012 | 106.37 | 115.65 | 18.72 | 139.59 | 171.18 | 105.85 |

### *b. Te Ardhurat nga Interesat*

Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesi per te gjitha instrumentet financiare interes-sjellese, pervec atyre te klasifikuara si te mbajtura per tregtine ose te percaktuara me vlere tregu nepermjet humbjes ose fitimit, njihen brenda 'te ardhura nga interesi' dhe 'shpenzime nga interesi' ne pasqyren e te ardhurave duke perdorur metoden efektive te interesit. Metoda efektive e interesit eshte nje metode per llogaritjen e kostos se amortizimit te nje aktivi financiar ose nje detyrimi financiar dhe ne caktimin e te ardhures se interesit ose te shpenzimit te interesit mbi periudhen perkatese. Norma efektive e interesit eshte norma qe skonton ekzaktesisht pagesat/te ardhurat e ardhshme nepermjet jetes se pritshme te instrumentit financiar ose një periudhe me te shkurter per te arritur ne vleren neto ne aktive ose detyrime.

Kur llogaritet norma efektive e interesit, Banka vlereson fluksin e parase duke marre parasysh te gjithe kushtet kontraktuale te instrumentit financiar (per shembull, opsionet parapagese) por nuk merr parasysh humbjet e ardhshme te kredive. Llogaritja përfshin te gjithe tarifat dhe piket e paguara ose te marra ndermjet paleve te kontrates qe jane nje pjese integrale e normes efektive te interesit, kostos se transaksionit dhe te gjitha premiove dhe skontimeve te mundshme. Pasi nje aktiv financiar ose nje Banke me aktive financiare te ngjashme ka patur humbje per shkak te demtimit, te ardhurat nga interesi njihet duke perdorur normen e interesit zbrites me qellim qe te matet humbja per shkak te demtimit.

Te ardhurat dhe shpenzimet te shfaqura ne pasqyren e te ardhurave perfshijne:

- Interesi ne aktivet dhe detyrimet financiare me koston e amortizuar ne bazen e nje norme interesi efektive. Interesat nga investimet ne tituj te rishitjes me një baze interesi efektiv
- Pjesa efektive e derivative te përcaktuara ne pasqyren e flukseve te arkes, nese kjo ka dale ne te ardhurat/ shpenzimet e interesit
- Ndryshimi i vleres se tregut te derivateve(duke perfshire mosefektivitetin) kur ekziston risku i ndryshimit te normes se interersit

c. ***Tatimi fitimi***

Tatimi mbi te ardhurat perfshin tatimet aktuale dhe ato te shtyra Shpenzimi. Tatimi mbi fitimin paraqitet ne PASh pervec kur kemi te bejme me nje artikull qe njihet drejteperdrejte ne kapital, ne nje rast te tille njihet ne kapital.

Tatimi aktual eshte taksa qe pritet te paguhet ne tabelen e te ardhurave per vitin, duke perdorur norma te taksave te miratuara ose te miratuara ne menyre te pavarur ne datën e bilancit, dhe cdo rregullim qe I behet takses se pagueshme ne lidhje me vitet e meparshme.

Tatimet e shtyra parashikohen duke perdorur metoden e bilancit, duke parashikuar diferenca te perkohshme mes shumes se mbartur te aktiveve dhe detyrimeve per qellime te raportimit financiar dhe te shumes se perdorur per qellime te taksimit. Tatimet e shtyra nuk njihen per diferencat e perkohshme te meposhtme: njohja fillestare e emrit te mire, njohjen fillestare te aktiveve ose detyrimeve ne nje transaksion qe nuk eshte nje kombinim biznesi dhe qe nuk ndikon as ne fitimin e kontabel as ne fitimin e tatueshem, dhe diferenca ne lidhje me investime shtese deri ne masen qe ata probabilisht nuk do te kthehen mbrapsht ne nje te ardhme te parashikueshme. Tatimet e shtyra maten me normat e taksave qe priten te zbatohen diferencave te perkohshme kur ato kthehen mbrapsht, bazuar ne ligjet qe ato jane miratuar ose qe jane miratuar ne menyre te pavarur ne datën e raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohëshme të zbritshme për aq sa ato ka mundësi të mbulohen nga fitimi i tatueshëm që do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit diferenca e përkohëshme e zbritshme të mund të përdoret. Aktivi tatimor i shtyre rishikohet ne cdo date te raportimit dhe reduktohet ne nje mase te tille qe nuk mund te jete me e mundshme te realizohet perfitimi ne lidhje me taksat. Tatimet shtese mbi te ardhurat qe lindin nga shperndarja e divideteve njihen ne te njejten kohe qe njihet edhe detyrimi per te paguar dividentin.

d. ***Aktivet financiare dhe detyrimet***

*(i) Njohja*

Banka njeh nje aktiv financiar ose nje detyrim financiar ne bilancin e saj kur, dhe vetem kur, Banka behet pale e dispozitave kontraktore te instrumentit. Titujt ne datën e maturimit, kredite dhe llogarite e arketueshme njihen ne datën e vendosjes, datë ne te cilen, nje aktiv dergohet tek ose nga nje entitet.

*(ii) Çrregjistrimi*

Aktivet financiare crregjistrihen kur eshte parashkruar e drejta per te marre flukse arke nga aktivet financiare ose kur Banka ka transferuar cdo risk dhe shperblim te pronesise. Cdo interes ne aktivet financiare te transferuara qe krijohet ose mbahen nga Banka njihet si nje aktiv ose detyrim I vecante. Banka crregjistron nje detyrim financiar kur detyrimet kontraktore jane shfuqizuar, shlyer ose I ka kaluar afati. Banka futet ne transaksione permes se ciles ajo transferon aktive te njohura ne bilancin e saj, por qe mban ose te gjitha risqet dhe shperblimet e aktiveve te transferuara ose nje pjese te tyre. Ne qofte se te gjithe ose pjesa me e madhe e risqeve dhe shperblimet jane mbajtur, atehere aktivet e transferuara nuk njihen nga bilanci. Transferimi aktiveve me mbajtjen e te gjithe ose te pjesës me te madhe te risqeve dhe shperblimeve perfshine,per shembull dhënien me qera te titujve dhe transaksioneve te riblerjes. Gjithashtu Banka nuk njeh aktive te caktuar kur ato i zbriten gjendjeve qe I takojne aktiveve qe konsiderohen si jo te mbledheshme (shih shenimin---).

*(iii) Kompensim*

Aktivet financiare dhe detyrimet jane te kompensueshme ne shumen neto te raportimeve ne bilanc kur ka nje te drejte te perforcuar ligjore per te kompensuar shumen e njohur dhe kur ka nje qellim per te vendosur mbi baze neto dhe te zgjidhe detyrimin ne te njejten kohe. Te ardhurat dhe shpenzimet paraqiten ne baza neto vetem kur kjo lejohet nga standartet e llogaritjeve ose per fitimet ose humbjet e lindura nga grupe e ngjashme transaksionesh si per shembull aktiviteti tregtar Bankar.

*(iv) Matja e kostos se amortizuar*

Kosteja e amortizueshme e nje aktivi apo detyrimi financiar eshte shuma me ane te te ciles nje detyrim apo aktiv njihet fillimisht, minus shumat e ripaguara, plus ose minus amortizimin e akumuluar i cili perllogaritet duke aplikuar metoden e interest efektiv per cdo diference qe mund te linde nga shuma e njohur fillestare dhe shumes ne maturim, minus cdo pakesim si rrejdhoje e testit te vleres.

*(v) Identifikimi dhe matja e Humbjes se Vleres*

Banka vlereson ne daten e bilancit nese ka tregues objektiv qe aktivet financiare te cilat nuk njihen me vleren e drejte nepermjet te ardhurave dhe shpenzimeve, rezultojne menje humbje vlere. Nje aktiv financiar rezulton te kete humbje vlere dhe si rrjedhoje vlera e tij zvogelohet per hete humbje vlere, vetem ne rast se ka prova objektive te humbjes se vleres si pasoje e nje ose me shume ngjarjeve qe ndodhen pas njohjes fillestare te aktivit (nje 'ngjarje humbjeje') dhe qe kjo ngjarje humbjeje (ose disa ngjarje) ka nje ndikim ne flukset e ardhshme te parase te vleresuara te aktiveve financiare ose kur keto aktive financiare mund te vleresohen ne menyre te besueshme. Kriteret qe perdor Banka per te percaktuar qe ka prova objektiv te nje humbje si pasoje e demtimit perfshijne:

• Shkelje ne pagimet kontraktuale te principalit ose te interesit;

• Veshtiresi ne shlyerje nga huamarresi (per shembull, % ne kapital, te ardhura neto nga perqindjet e shitjeve);

• Prishje te kontrates ose kushteve te huadhenies;

• Fillimi i procedurave te falimentimit;

• Perkeqesim te pozicionit konkurrues te huamarresit;

• Perkeqesim te vleres se kolateralit;

Periudha e vleresimit midis nje humbje dhe identifikimit te saj percaktohet nga drejtimi per cdo humbje te identifikuar. Ne pergjithesi, periudha varion midis 3 dhe 12 muajve; ne raste te vecanta garantohen periudha me te gjata. Fillimisht Banka vlereson nese ekzistojne prova objektive per humbje te vleres ne menyre individuale per aktive qe jane individualisht te rendesishme. Ne rast se Banka percakton qe nuk ekzistojne prova objektive per humbje vlere te nje aktivi financiar te vleresuar individualisht, nese eshte i rendesishem ose jo, Banka i perfshin keto ne aktive me karakter te ngjajshem financiar duke llogaritur riskun e kredise dhe i vlereson ne menyre te perbashket per qellim te velresimti te humbjes se vleres. Aktivet te cilat vleresohen individualisht per humbje vlere dhe per te cilen ekziston nje humbje e vleres qe vazhdon te njihet, nuk perfshihen ne nje vleresim te perbashket te humbjes. Shuma e humbjes matet si diferenca ndermjet shumes se mbartur te aktivit dhe nje vleres aktuale te fluksit te ardhshem te parase (duke perjashtuar humbjet e ardhshme te kreditit qe nuk jane pesuar) te zbritura nga norma fillestare e interesit te aktivit financiar. Shuma e mbartur e aktivit ulet nepermjet nje llogarie lejuese dhe shuma njihet ne pasqyren e te ardhurave. Ne rast se nje hua ose nje investim deri ne maturim ka nje norme interesi te ndryshueshme, norma e uljes per te matur cdo humbje nga demtimi eshte norma efektive aktuale e interesit e percaktuar nga kontrata.

*(vi) Percaktimi me vlere tregu nepermjet fitimit dhe humbjes*

Banka ka percaktuar aktive financiare dhe detyrime me vlere tregu nepermjet fitimit dhe humbjes kur ose: aktivet ose detyrimet menaxhohen, vleresohen dhe raportohen ne bazen e vleres se tregut percaktimi eliminon ose ul ndjeshem nje mosperputhje kontabiliteti e cila ne ndryshe do te lindte, ose aktivi ose detyrimi permban nje derivativ qe ndryshon ndjeshem fluksin e parave do te kerkohej si pasoje e zbatimit te kontrates.

### e. *Paraja dhe ekuivalentet e parase*

Paraja dhe ekuivalentet e parase perfshijne parane ne dore, llogari rrjedhëse te mbajtura me Bankat qendrore dhe aktivet financiare shume likuide me maturitet origjinal ne me pak se 3 muaj, te cilat kane risk minimal, dhe qe jane perdorur nga Banka ne menaxhimin e angazhimeve afat-shkurter. Paraja dhe ekuivalentet e parase mbarten me koston e tyre te amortizuar ne bilanc.

### f. *Huate dhe paradheniet*

Huatë dhe Paradhëniet janë aktive financiare jo-derivativ me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk kuotohen në një treg aktiv, përveç rasteve kur: (a) ato që Banka planifikon ti shesë menjëherë ose në afatshkurtër, të cilat janë të klasifikuara si te mbajtura per tregtim, dhe ato që Banka që në momentin e parë i klasifikon si vlerë e drejtë përmes fitimit ose humbjes; (b) ato që Banka i kalsifikon si të disponueshme për shitje; ose (c) ato që mbajtësit nuk mund të rikuperojë tërësisht gjithë vlerën e investimit fillestare, përveç rastit të përkeqësimit të indeksit të kreditit. Huatë dhe Paradhënie njihen kur Banka u bë pjesë e një marrëveshjeje kontraktuale. Huatë dhe Paradhëniet fillimisht maten me kostot duke përfshirë çdo transaksion kostoje të ndodhur, ndërsa më pas maten me koston e amortizuar minus çdo humbje nga zhvlerësimi.

### g. *Investimet*

Investimeve jane matur fillimisht me vlere tregu plus ndonje kosto direkte te transaksioneve dhe per pasoje i klasifikon si instrumentat"te mbajtur deri ne maturim", me te njohur nepermejt te ardhuarve dhe shpenzimeve dhe te vlefshme per shitje.

### h. *Te mbajtura deri ne maturim*

Letrat me vlere te mbajtura deri ne maturim jane aktive jo-derivative me pagese te percaktuar ose te percaktueshme dhe maturitet te percaktuar qe Banka ka per qellim fitimi dhe ka aftesine per ti mbajtur deri ne maturitet, dhe te cilat nuk përcaktohen me vleren e tregut permes fitim/humbjes apo te jene te vlefshme per shitje. Letrat me vlere te mbajtura deri ne maturim mbarten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv. Cdo shitje ose riklasifikim te nje shume te rendesishme te letrave me vlere te mbajtura deri ne maturim te cilat nuk jane afer maturitetit te tyre do te rezultonte ne nje riklasifikim te te gjitha letrave me vlere te mbajtura deri ne maturim si te vlefshme per shitje, dhe do ta ndalonte Banken te klasifikonte titujt si deri ne maturim per vitin ne vijim dhe dy vitet pasardhese financiare.

### j. *Qiraja*

(a) Banka eshte qiramarres:

Qirate ku eshte perfshire Banka jane kryesisht qira operative. Pagesa totale te bera nen qerate operative I ngarkohen shpenzimeve te tjera operative ne pasqyren e te ardhurave me pagesa lineare gjate periudhës se qirasë. Kur nje qira operative përfundohet përpara se te mbaroje afati i qirasë, cdo pagese qe duhet ti behet qiradhënësit si penalitet njihet si shpenzim ne periudhen ne te cilen ndodh përfundimi I kontrates.

### k. *Aktivet afatgjata materiale*

#### (i) *Njohja dhe matja*

Aktivet Afatgjata maten me kosto duke zbritur amortizimin si dhe humbjet qe vijne nga demtimet. Kostoja perfshin shpenzime te cilat i atribuohen drejteperdrejte blerjes se aktivit. Kostoja e aktiveve te vete-ndertuara perfshin koston e materialeve dhe punes se drejteperdrejte, dhe cdo kosto tjeter qe ka te beje me sjelljen e aktivit ne gjendje pune per qellimin per te cilin do te perdorej, dhe kostot e cmontimit dhe heqjes se artikujve dhe kthimin e sheshit ne te cilin ata ndodheshin. Software-t e blera qe jane integrate me funksionimin e paisjes parashikohet si pjese e paisjes. Kur pjese te nje artikulli te prones ose te paisjeve kane jete te ndryshme te perdorshme, ato llogariten si artikuj te vecante (perberes kryesor) te prones ose paisjes.

*(ii) Kostot pasardhese*

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje artikulli te prones ose te paisjeve njihet ne shumen e mbartur te nje artikulli ne rast se eshte e mundshme qe perfitimet e ardhshme ekonomike te perfshira ne pjese do ti vijne Bankes dhe kostoja e saj mund te matet ne menyre te besueshme. Kostoja e sherbimeve te perditshme te prones dhe paisjeve njihen ne pasqyren e fitim ose humbje sic jane pesuar.

*(iii) Amortizimi*

Amortizimi njihet ne fitim ose humbje ne një baze lineare gjate jetes se dobishme. Aktivet e dhena me qira amortizohen gjate periudhes se tyre te shkurter te qirase dhe jeteve te tyre te perdorshme. Toka nuk amortizohet. Metodat e amortizimit, jetea e dobishme dhe vlerat e mbetura rivleresohen ne datën e raportimit. Inventaret dhe paisjet deklarohen me koston duke zhvleresuar nga amortizimi, e cila llogaritet ne baza lineare pergjate jeteve te dobishme te aktiveve. Normat vjetore te amortizimit jane si me poshte:

| | |
|---|---|
| • ndertesa | 5% |
| • Paisjet e zyres | 10%-25% |
| • Mobiljet | 10%-25% |
| • Paisjet elektronike dhe informatike | 25% |

## l. *Aktivet jo-materiale afatgjata*

*(i) Software-t*

Software-t e blera nga Banka deklarohen me kosto minus humbjet e akumuluara nga demtimet. Shpenzimet e mepasme per aktive software-sh kapitalizohet vetem kur ajo rrit perfitimet e ardhshme ekonomike te perfshira ne aktivet specifike me te cilen ajo ka lidhje. Te gjitha shpenzimet e tjera njihen si shpenzime te ushtrimit. Amortizimi njihet ne fitim ose humbje me baze lineare pergjate jetes se dobishme se software-it, nga data ne te cilin ai eshte I gatshem per t'u perdorur. Jeta e dobishme e software-it eshte 3 deri ne 5 vjet.

Normat vjetore te amortizimit jane si me poshte: Software 25%

## m. *Testi i Vleres i aktiveve jo-financiare*

Shuma e mbartur e aktiveve jo financiare te Bankes, ndryshe nga investimet ne prona dhe taksat e shtyra te aktiveve jane rishikuar ne cdo datë te raportimit per te percaktuar nese ka ndonje tregues te humbjes se vleres.. Nese ekziston ndonje tregues I tille atehere vleresohet shuma e rikuperueshme e aktivit. Shuma e rikuperueshme e (miratuar) i emrit te mire vleresohet ne cdo datë te raportimit.

